



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

Nr. 19 datë 14.06.2010

PER

“ AKSESIN DHE INTERKONEKSIONIN”

*Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1300, Datë 14.06.2010.
Ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1373, Datë 10.09.2010*

RREGULLORE

Nr.19, date 14.06.2010

PËR AKSESIN DHE INTERKONEKSIONIN

Në mbështetje të shkronjave b) dhe p) të nenit 8 dhe pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që në përputhje me objektivat rregullatorë dhe normimet ligjore për aksesin dhe interkoneksionin të përcaktuara në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të nxitet dhe nëse është e nevojshme të detyrohet realizimi i aksesit dhe interkoneksionit, si dhe bashkëveprimi i shërbimeve, duke synuar nxitjen e konkurrencës së qëndrueshme dhe efiçente, për përfitim maksimal të përdoruesve fundorë.

Neni 2

Objekti i rregullores

Objekti i rregullores është përcaktimi i rregullave të hollësishme në plotësim të dispozitave ligjore të përcaktuara në nenin 39 e vijues të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” për aksesin dhe interkoneksionin, si dhe zbatimin nga sipërmarrësit të detyrimit ligjor për të publikuar një ofertë reference.

Neni 3

Përkufizime

Përveç përkufizimeve të nenit 3 të ligjit 9918 termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “*Ligji*” këtej e tutje nënkupton ligjin nr 9918, datë 19.05.2009 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. “*Oferta e referencës*” është një ofertë e publikuar nga një sipërmarrës për shërbimet dh/ose facilitetet e aksesit sipas detyrimeve të neneve 39, 47 ose 52 të ligjit.

3. “*Operator ofruës*” është operatori i një rrjeti të komunikimeve elektronike publike i cili është i detyruar të japë akses sipas ligjit.
4. “*Operatori përfitues*” është operatori i një rrjeti publik të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, i cili ka aplikuar me shkrim për akses.
5. “*Bashkëvendosje*” është shërbimi i cili mundëson vendosjen e përshtatshme të pajisjeve të operatorit përfitues dhe lidhjen e tyre tek pajisjet korresponduese të operatorit ofruës.
6. “*Bashkëvendosje fizike*” është bashkëvendosja e pajisjeve të operatorit përfitues në të njëjtat mjedise ku operatori, i cili ofron aksesin, ka të vendosur elementin e rrjetit të tij, në të cilin ofrohet akses
7. “*Bashkëvendosje në distancë*” është bashkëvendosja e pajisjeve të operatorit përfitues në mjedise të operatorit ofruës të aksesit, të ndryshme nga ato në të cilat ky operator ka të vendosur elementin e rrjetit të tij, në të cilin ofrohet akses
8. “*Bashkëvendosje virtuale*” është vendosja e pajisjeve korresponduese të operatorit përfitues, përmes instalimit të tyre në të njëjtin permutator, (distribution frame) pranë një elementi të rrjetit në të cilin ofrohet akses dhe që operohet nga operatori ofruës
9. “*Pika e interkoneksionit*” është një pikë e përcaktuar gjeografikisht në rrjetin publik të komunikimeve elektronike të operatorit ofruës, ku operatori ofruës dhe operatori përfitues janë të interkonektuar.
10. “*Qarku lokal*” është qarku fizik, që lidh pikën fundore të rrjetit tek permutatori (MDF) ose pajisjet e barasvlershme në rrjetin publik telefonik fiks.

KREU 2 AKSESI DHE INTERKONEKSIONI

Neni 4

Detyrime të përgjithshme për të ofruar akses dhe interkoneksion

1. Të gjithë operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike kanë të drejtën dhe, kur iu kërkohet nga operatorët e tjerë të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike dhe/ose ofruësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, detyrimin për të negociuar me njëri-tjetrin për aksesin tek rrjetet e tyre respektive.
2. Interkoneksioni është një lloj i veçantë aksesit i implementuar ndërmjet operatorëve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike. Të gjithë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik kanë të drejtën dhe, kur iu kërkohet nga operatorët e tjerë të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe/ose ofruësit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, detyrimin për të negociuar me njëri-tjetrin për interkonektimin e rrjeteve respektive.
3. AKEP vendos mbi operatorët me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të ofruar akses dhe interkoneksion sipas procedurave të neneve 31 deri në 46 të ligjit.
4. AKEP mund të detyrojë operatorët që nuk kanë fuqi të ndjeshme në treg të ofrojnë akses dhe interkoneksion, nëse kjo është e nevojshme për të siguruar lidhjet fund-

me – fund, në bazë të procedurës së nenit 49 të ligjit.

5. Operatorët do të ofrojnë akses dhe interkoneksion tek operatorët e tjerë në bazë të kushteve dhe termave në përputhje me detyrimet e vendosura atyre nga AKEP-i në bazë të ligjit dhe kësaj rregulloreje.
6. Dispozitat e këtij neni do të gjejnë zbatim tek të gjithë operatorët që kanë njoftuar sipas nenit 14 të ligjit për të ofruar një rrjet publik të komunikimeve elektronike, pavarësisht nga teknologjitë që ata përdorin në rrjetet e tyre dhe pavarësisht nga madhësia e rrjetit të tyre.

Neni 5

Interkoneksioni i rrjeteve publike të telefonisë

1. Të gjithë operatorët që kanë njoftuar sipas nenit 14 të ligjit për ofrimin e rrjeteve publike të telefonisë mund të kërkojnë interkoneksion me operatorët e tjerë të rrjeteve publike të telefonisë sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje.
2. Rrjete publike të telefonisë janë rrjetet që ofrojnë shërbim telefonik të disponueshem për publikun.
3. Shërbimi publik telefonik është shërbimi i komunikimeve elektronike që në të njëjtën kohë plotëson katër kriteret e mëposhtme:
 - a) një shërbim i tillë është objekt i ofrimit komercial (shërbimi që ofrohet në bazat e tregut, me qëllimin për të gjeneruar fitim);
 - b) një shërbim i tillë ofrohet publikisht (që është i mundshëm për të gjithë në kushte të barabarta dhe të publikuara);
 - c) ky shërbim sigurohet për dhe nga pikat fundore të rrjetit të komunikimeve publike elektronike, nëpërmjet komunikimit zanor të vendosur midis dy pikave fundore të rrjetit të komunikimeve publike në të njëjtën kohë. Këto pika fundore përfaqsojnë përdoruesit e shërbimit që përdorin numrat në përputhje me Planin e Adresave dhe Planin e Numeracionit;
 - d) ky shërbim përfshin transmetimin direkt dhe komutimin e zërit në kohë reale, duke përfshirë përdorimin e protokollit të internetit brenda rrjetit në të cilin ndodhet i gjithë kanali i kontrollit të thirrjes (shërbim që siguron vonesa kohore të kufizuara dhe të garantuara të sinjaleve).
4. Në rastin e dyshimit për plotësimin e ndonjë prej kriteve referuar pikës 3 të këtij neni, AKEP, kur është e nevojshme, do të përcaktojë nëse plotësohen kriteret e mëposhtme shtesë (plotësuese):
 - e) nëse ky shërbim reklamohet si një zëvendësues për shërbimin publik telefonik në rrjetin publik telefonik;
 - f) nëse operatori siguron (garanton) cilësinë e zërit gjatë gjithë rrugës së thirrjes;
 - g) nëse ky shërbim përfaqson të vetmin mjet për përdoruesit e shërbimit për akses në rrjetin publik telefonik.
5. Marrëveshjet e interkoneksionit dhe ofertat e referencës mund të përmbajnë rregulla të cilat parashikojnë që disa tipe të caktuara të thirrjeve të telefonisë me zë duhet të dorëzohen në disa pika të caktuara interkoneksioni.
6. Të gjithë operatorët që ofrojnë apo kërkojnë akses/interkoneksion, pavarësisht statusit me FNT ose jo, duhet të zbatojnë detyrimet e përcaktuara nga ligji dhe

kuadri rregullator, përfshirë kërkesat në ofertat reference në lidhje me detyrimin për mos-tjetërsim dhe/ose fshehje të CLI dhe zbatimin e standarteve të cilësisë së shërbimeve.

7. Operatoret e rrjeteve publike telefonike duhet:
- a) Të sigurojnë plotësimin e standarteve dhe cilësisë së shërbimit për shërbimet e ofruara të interkoneksionit, sipas treguesve të QoS të përcaktuar në seksionet 5, 6 dhe 7 të dokumentit ETSI TR 101 949 V1.1.1 (2002-07) (publikuar në gjuhën shqipe në faqen e Internetit të AKEP – www.akep.al/legjislacioni/standarde):
 - Parametrat QoS për interkoneksionin;
 - Parametrat QoS për terminimin dhe origjinimin (përfshirë tranzitimin) e thirrjeve;
 - Parametrat QoS për shërbime të tjera.
 - b) Të zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga rregullorja “Për treguesit e cilësisë së shërbimit” të miratuar nga AKEP me vendimin Nr.1256, datë 16.04. 2010, dhe të shkëmbejnë këtë informacion me operatoret e interkonektuar për të siguruar cilësi të njëjtë të shërbimeve të interkoneksionit të ofruara operatorit tjetër, të referuar me sipër (shkronja a) me shërbimet e ofruara përdoruesve fundore në rrjetet respektive publike telefonike të tyre.
8. Palët e interkonektuara shkëmbejnë të dhëna për QoS çdo muaj brenda datës 5 të muajit pasardhës. Në rast se njera palë nuk zbaton standartet e cilësisë, pala tjetër ka të drejtë të pezullojë ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit, pasi ka ezauruar procesin e paralajmerimit duke i dërguar fillimisht njoftim palës tjetër, si dhe AKEP-it.
9. (Ndryshuar me VKD Nr.1373, datë 10.09.2010 “Për disa ndryshime në Rregulloren Nr. 19. date 14. 06. 2010, “Për Aksesin dhe Interkoneksionin””)
- Në rastet kur një operator në bazë të provave që disponon faktin se pala tjetër modifikon apo fsheh CLI e thirrjeve të përcjella nga kjo palë, operatori ka të drejtë të paralajmërojë me shkrim operatorin në shkelje duke njoftuar njëkohësisht dhe AKEP-in, për pezullimin e ofrimit të shërbimeve të interkoneksionit, nëse në mënyrë të menjëhershme dhe në çdo rast jo më vonë se brenda një afati prej 24 orësh nga marrja e njoftimit, nuk ndërpritet shkelja e konstatuar. Në njoftimin e dërguar përfshihen provat që faktojnë shkeljen e pretenduar, seritë numerike të cilat janë keqpërdorur, si dhe masa e pezullimit që do të merret nga operatori ankimues nëse shkelja nuk ndërpritet brenda afatit të caktuar. Brenda këtij afati operatori në shkelje duhet të ndërpresë menjëherë shkeljen e njoftuar ose nëse pretendon se nuk ka kryer asnjë shkelje të paraqesi kundërshtimet dhe provat e tij pranë operatorit njoftues dhe AKEP, duke i njoftuar paraprakisht në rrugë elektronike dhe brenda 5 ditëve kalendarike të paraqesi provat që disponon.**
10. (Ndryshuar me VKD Nr.1373, datë 10.09.2010 “Për disa ndryshime në Rregulloren Nr.19, datë 14. 06. 2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin””)

Operatori i njoftuar për shkeljen ka detyrimin që të përgjigjet menjëherë kundrejt njoftimit të marrë.

- a) Në rast se operatori i njoftuar për shkeljen nuk e ndërpret atë brenda afatit të caktuar në njoftim ose nëse pretendon se nuk e ka kryer shkeljen, nuk njofton paraprakisht në rrugë elektronike dhe brenda afatit 5 ditor nuk paraqet provat që vërtetojnë pretendimin e tij, atëhere operatori që ka bërë njoftimin për shkelje pezullon ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit sipas njoftimit të bërë;
 - b) Në se operatori i njoftuar për shkeljen nuk ndërpret shkeljen e faktuar brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit ose nuk dërgon mesazhin paraprak se nuk është në shkelje dhe për këtë do të dërgojë provat e tij brenda 5 ditëve, atëhere operatori i dëmtuar pezullon në fund të këtij afati ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit;
 - c) Në rast se operatori i njoftuar për shkeljen dërgon mesazhin paraprak se nuk është në shkelje dhe për këtë do të paraqesi brenda afatit provat e tij dhe në përfundim të këtij afati nuk paraqet asnjë provë, atëhere operatori i dëmtuar ndërpret pas 5 ditëve nga njoftimi i bërë, ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit;
 - ç) Operatori në shkelje është përgjegjës për shkeljen e kryer nëse provat e paraqitura prej operatorit të dëmtuar vërtetohen nga AKEP dhe për këtë me vendim të arsyetuar e ndëshkon atë me masa administrative në përputhje me përcaktimet ligjore për këtë qëllim;
 - d) Operatori që pretendon shkeljen është përgjegjës nëse pretendimet e tij për shkelje nuk vërtetojnë shkeljen e pretenduar. Në një rast të tillë AKEP me vendim të arsyetuar mban qëndrim dhe vendos masa administrative kundrejt këtij operatori;
 - e) Secila nga palët ka të drejtë që t'i drejtohet AKEP-it për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 120 të ligjit nr. 9918 dhe Rregullores “Për procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296 date 11.06.2010 si dhe Gjykatës kompetente për të apeluar vendimin e AKEP-it.
11. Pala që pezullon shërbimet e interkoneksionit, ka përgjegjësisinë e dëmshpërblimit të palës tjetër në rast se nga Gjykata kompetente gjendet fajtores për pezullim jo të bazuar në kuadrin rregullator dhe ligjor.

Neni 6

Parime të përgjithshme

1. Operatori ofrues i aksesit ka detyrimin të vendosë çmimet për shërbimet e përfshira në ofertën referencë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe/ose akteve të nxjerra në zbatim të tij.
2. Operatori ofrues mund të refuzojë dhënien e aksesit për një operator përfitues vetëm në bazë të kritereve objektive, të tilla si pamundshmëria teknike apo nevoja

për të ruajtur integritetin e rrjetit. Operatori ofruës ka detyrimin të provojë pamundësinë e ofrimit të një shërbimi të caktuar.

3. Operatori ofruës nuk mund të kufizojë autorizimin e përgjithshëm të operatorit përfitues për të ofruar rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike nëpërmjet reduktimit të qëllimit të aksesit të ofruar.
4. Operatori ofruës, në rastet kur refuzon t'i sigurojë operatorit përfitues shërbimet e specifikuar në ofertën referencë dhe e motivon këtë refuzim me mungesën e mundësive teknike, ai ka detyrimin t'i paraqesë operatorit përfitues një shpjegim gjithëpërfshirës të arsyeve të refuzimit dhe të specifikojë afatin kohor të saktë në të cilin kërkesa do të përmbushet. Kur operatori ofruës refuzon të sigurojë shërbimet e specifikuar në ofertën referencë për operatorin përfitues për shkak të kritereve të tjera të përmendura në pikën 2 të këtij neni, operatori ofruës duhet, gjithashtu, të specifikojë kushtet që duhet të plotësojë operatori përfitues me qëllim që operatori ofruës të jetë në gjendje të përmbushë kërkesën. Për secilin rast të specifikuar në këtë paragraf, kur operatori ofruës paraqet shpjegime për operatorin përfitues, kopje të këtyre shpjegimeve i depozitohen njëkohësisht dhe AKEP-it.
5. Në rast se ndonjë prej shërbimeve të specifikuar në ofertën referencë vonohet të sigurohet nga operatori ofruës jo për shkaqe të operatorit përfitues, operatori ofruës duhet të njoftojë operatorin përfitues për këtë në mënyrë të menjëhershme, duke paraqitur një shpjegim gjithëpërfshirës të arsyeve të kësaj vonese dhe të specifikojë afatin kohor të saktë në të cilin operatori ofruës do të lëvrojë shërbimin e kërkuar për operatorin përfitues.
6. Operatori ofruës nuk mund të vendosë kufizime të elementeve të rrjetit për ofrimin e shërbimeve të tjera përveç atyre të përcaktuara në standartet e aplikueshme dhe specifikimet teknike të përkufizuara nga to, duke përfshirë kufizime të interkoneksionit dhe elementet e interkoneksionit me rrjetet publike të komunikimit.
7. AKEP mund të detyrojë operatorët ofruës që t'i mundësojnë operatorit përfitues të kryejë transaksione të përdorura shpesh nëpërmjet rrugëve elektronike, në veçanti nxjerrja e informacionit, paraqitja e porosive dhe rregullimi i defekteve.
8. Kushtet e përcaktuara tek oferta e referencës nuk mund të kufizojnë kohëzgjatjen e shërbimeve të specifikuar aty. Ofrimi i shërbimeve i përshkruar në ofertën e referencës mund të pezullohet ose të përfundohet në mënyrë të njëanshme vetëm në rastet e mëposhtme:
 - a) Operatori përfitues anulon aksesin tek shërbimet e ofruara.
 - b) Operatori ofruës përfundon kohën e veprimit të elementit të rrjetit të përdorur për ofrimin e aksesit tek operatori përfitues. Një përfundim i tillë nuk duhet të shkelë detyrimet e vendosura mbi operatorin ofruës sipas nenit 42 të ligjit. Operatori ofruës duhet të informojë operatorin përfitues për një përfundim të tillë të paktën 6 muaj para kohe.
 - c) Operatori përfitues shkel dispozitat themelore të marrëveshjes së aksesit. Operatori ofruës do të njoftojë menjëherë AKEP-in për secilin prej këtyre rasteve.

- d) Kur ka kritere të tjera të përcaktuara në ligj dhe aktet e lëshuara për zbatimin e tij.
9. Operatori ofrues dhe operatori përfitues do të njoftojnë menjëherë njëri-tjetrin dhe AKEP në rast se rrjetet e interkonektuara pushojnë së funksionuara për shkak të ndonjë rasti të forcës madhore ose situatë emergjence.

Neni 7

Procedura për të kërkuar informacion

1. Operatori ofrues dhe operatori përfitues jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e kërkesës, nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti në formë standarde, siç përmendet në paragrafin vi të shkronjës n) të nenit 11, të kësaj rregulloreje.
2. Me nënshkrimin e marrëveshjes së konfidencialitetit nga operatori ofrues dhe operatori përfitues pa kufizime ose kushte shtesë, operatori ofrues i jep operatorit përfitues informacionin e përgjithshëm të përmendur në pikën 3 të këtij neni dhe informacionin e detajuar të përmendur në pikën 6 të këtij neni pa çënuar kufijtë kohorë të specifikuar në pikën 5 dhe 7 të këtij neni. Në rast se i gjithë apo pjesë të informacionit të përshkruar në pikat 3 dhe 6 të këtij neni, janë pjesë e ofertes reference, operatori ofrues duhet të japë referencat në oferten reference ku mund të gjendet ky informacion.
3. Operatori ofrues, kur i siguron operatorit përfitues Informacionin e Përgjithshëm të rrjetit që operon, paraqet një listë të detajuar të të gjitha elementeve të tij të rrjetit, në të cilat mund të sigurohet akses, duke specifikuar sa më poshtë për secilin element rrjeti:
 - a) Adresën;
 - b) Topologjinë e rrjetit të operuar, në të cilin sigurohet akses;
 - c) Territorin e shërbyer nga elementi i rrjetit;
 - d) Datat e skadimit të periudhës kohore të operimit të elementit të rrjetit dhe pjesëve përbërës të tij;
 - e) Hapësirat e ambienteve, (në metër katror), në të cilat është vendosur elementi i rrjetit ku sigurohet akses dhe përshkrimet teknike të ambienteve;
 - f) Mundësitë e sigurimit dhe/ose instalimit të bashkëvendosjes fizike dhe/ose në distancë dhe/ose virtuale në ambientet e tij, siç përmendet në pikën 3, e) më lart, në ambientet e specifikuara apo në ambiente pranë tyre;
4. AKEP-i mund të detyrojë operatorët ofrues që të ofrojnë një faqe interneti të sigurt ku operatori përfitues të mund të gjejë të gjithë informacionin e përgjithshëm të specifikuar më lart. Aksesin në këta faqe interneti sigurohet nëpërmjet një kanali të kriptuar.
5. Operatori ofrues i aksesit siguron disponibilitetin e informacionit të përgjithshëm të përhapjen e negociatave, që prej datës së publikimit të ofertës referencë. Operatori

ofruet e përditëson informacionin në një mënyrë të tillë që të garantojë që ky informacion pasqyron kapacitetet dhe mundësitë për të siguruar shërbimet e specifikuar në ofertën referencë.

6. Operatori ofruet, kur i ve në dispozicion operatorit përfitues informacionin e detajuar për karakteristikat e elementëve të veçante të rrjetit në të cilin ofrohet akses, specifikon sa më poshtë:
 - a) Karakteristikat elektrike dhe fizike;
 - b) Karakteristikat e transmetimit;
 - c) Parametrat teknikë dhe të cilësisë, në rastin e sigurimit të aksesit në rrjetin lokal, rezultatet shtesë të matjeve të parametrave korrespondues teknikë dhe atyre të cilësisë;
 - d) Karakteristikat e sinjalizimit të përdorur;
 - e) Të gjitha të metat e elementëve të rrjetit në të cilin operatori përfitues kërkon të sigurojë akses, për të cilat operatori ofruet ka dijeni;
 - f) Informacionin për kapacitetet e mundshme të lidhjes.
7. Operatori ofruet ia paraqet operatorit përfitues informacionin e detajuar, të përmendur në pikën 6 më lart dhe informacione të tjera të lidhur me sigurimin e shërbimeve të përshkruara në ofertën referencë, jo më vonë se 10 ditë nga data e marrjes së kërkesës për sigurimin e informacionit. Informacioni i detajuar në pikën 6 do të jepet nga operatori ofruet jo më vonë se 10 ditë pas dhënies nga operatori përfitues të informacionit të plotë dhe sipas kërkesave të ofertës referencë të referuar në pikën 10 më poshtë.
8. Me fillimin e negociatave për sigurimin e shërbimeve të specifikuar në ofertën referencë, operatori ofruet i vë në dispozicion operatorit përfitues të gjithë informacionin e lidhur me shërbimet, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së kërkesës për këtë informacion.
9. Operatori ofruet dhe operatori kërkues duhet të bashkëpunojnë në mirëbesim dhe duhet të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm me njëri-tjetrin për të mundësuar vendosjen e zgjidhjes së akses/Interkoneksionit, si për anën teknike dhe atë komerciale, brenda afateve ligjore. Informacioni i shkëmbyer midis dy palëve duhet të përfshijë përveç të tjerave:
 - a) Shkëmbim informacioni lidhur me Kodin(et) e Pikave të Sinjalizimit, caktuar nga AKEP sipas rekomandimeve të SS7;
 - b) Shkëmbim informacioni lidhur me planin numerik të caktuar çdo pale.
 - c) Shkëmbim informacioni lidhur me plotësimin e parametrave të cilësisë referuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.
10. Në kërkesën për akses/interkoneksion, operatori përfitues duhet t'i japë operatorit ofruet informacionin e nevojshëm për të mundësuar zgjidhjen teknike dhe komerciale të akses/interkoneksionit, sipas kërkesave të përcaktuara në ofertën referencë të operatorit ofruet, të tilla si:
 - a) Propozim mbi vendodhjen e Interkoneksionit;

- b) Struktura e Rrjetit;
 - c) Propozim mbi rrugëzimin e trafikut;
 - ç) Adresat e nyjeve të komutimit;
 - d) Karakteristikat e paisjes së transmetimit të përdorur për Interkoneksion;
 - e) Karakteristikat e paisjes së komutimit të përdorur për Interkoneksion;
 - f) Shërbimet e kërkuara: zanore, të dhëna, faks, etj.
 - g) Seritë numerike që do të përfshihen;
 - i) Parashikime për trafikun që do shkëmbehet.
11. Në rast se informacioni i dhënë nga operatori kërkues nuk plotëson kërkesat e paraqitura në ofertën referencë të operatorit ofrues, operatori ofrues duhet të njoftojë brenda 10 ditëve operatorin kërkues duke i kërkuar plotësimin e informacionit.
12. Operatori përfitues, pavarësisht statusit me FNT ose jo, është i detyruar të japë informacion për tarifatat e shërbimeve të ofruara prej tij dhe që paguhen nga operatori ofrues.

Neni 8

Ofrimi i bashkëvendosjes

1. Operatori ofrues ka detyrimin t'i ofrojë mundësinë operatorit përfitues për instalimin e pajisjeve të nevojshme për sigurimin e shërbimeve të përmendura në ofertën referencë në një vend të bashkëvendosjes.
2. Operatori ofrues ka detyrimin të ofrojë të pakten një nga mënyrat e implementimit të bashkëvendosjes të specifikuar në pikat 3, 4, dhe 5 të këtij neni në secilën pikë të rrjetit në të cilën mund të sigurohet akses.
3. Operatori ofrues ofron bashkëvendosje virtuale në rast se ai nuk ka mundësi teknike për të alokuar bashkëvendosjen fizike për të cilën operatorit përfitues ka paraqitur një kërkesë. Në rastin e bashkëvendosjes virtuale, stafi i operatorit ofrues do të ekzekutojë instalimin dhe mbikqyrjen e të gjitha pajisjeve të operatorit përfitues.
4. Operatori ofrues alokon hapësirën e bashkëvendosjes fizike në të njëjtat ambiente të tij ku ndodhet i instaluar elementi i rrjetit tek i cili sigurohet akses sipas prioritetit në vijim:
 - a) Pa instalime të ndarjeve apo të strukturave të tjera mbrojtëse;
 - b) Me instalime të një ndarjeve apo një tjetër strukturë mbrojtëse, e cila kryhet nga operatori ofrues në emër të operatorit përfitues dhe kundrejt një pagese.
5. Operatori ofrues alokon hapësirën e bashkëvendosjes në distancë në ambientet e tij sipas prioritetit në vijim:
 - a) Në një dhomë të veçantë, të ndryshme nga ajo në të cilën është instaluar permutatori kryesor apo i ndërmjetëm, ose;
 - b) Në dhoma të pa-pajisura të operatorit ofrues, instalimi kryhet nga operatori ofrues me pagesë nga operatorit përfitues, apo nga vetë operatorit përfitues me shpenzimet e tij për të pajisur apo përshtatur këto dhoma. Kur operatorit ofrues refuzon të kryejë punët e sipërpërmendura, ai lejon operatorin përfitues

t'i kryejë ato.

6. Kur operatori përfitues pajis një hapësirë të bashkëvendosjes në ambientet e tij, operatori ofrues:
 - a) Ofron një kabëll lidhës të jashtëm. Në rastin kur operatori përfitues vendos ta blejë shërbimin prej një operatori tjetër apo ta vendosë kabllin vetë, operatori ofrues e informon operatorin përfitues për mundësinë e përdorimit të tubacioneve të tij apo fasiliteve të tjera shoqëruese, ose;
 - b) Ofron një mundësi për të instaluar një sistem antenë për lidhjen e pikës së aksesit me rrjetin, i cili vihet në punë nga operatori përfitues përmes radiokomunikimit.
7. Në rast se bashkëvendosja në pikën e aksesit, e zgjedhur nga operatori përfitues, instalohet në mënyrat e përmendura në pikën 4.b apo 5.b të këtij neni, operatori ofrues:
 - a) Brenda 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, në rastet e përmendura në pikën 4.b apo 5.b të këtij neni përgatit dhe i paraqet operatorit përfitues vlerësimin e kostove të punimeve (preventivin), të nevojshme për instalimin e bashkëvendosjes;
 - b) Brenda një afati 36 ditor, në rastin e përmendur në paragrafin 4.b të këtij neni ose brenda një afati 60 ditor në rastin e përmendur në pikën 5.b të këtij neni që prej momentit të marrjes së miratimit prej operatorit përfitues për vlerësimin e kostove të punimeve, operatori ofrues e pajis plotësisht hapësirën e bashkëvendosjes.
8. Në rastet kur bashkëvendosja në një pikë të caktuar bashkëvendosjeje të instaluar me shpenzimet e operatorit përfitues në një prej mënyrave të përmendura në pikat 4.b) dhe 5.b) të këtij neni, i jepet një tjetër operatori përfitues, operatori ofrues përcakton rregullat e kompensimit për shpenzimet e bëra nga operatori përfitues që kanë lidhje me procesin e mbushjes së hapësirës së bashkëvendosjes nga operatori i mëparshëm përfitues, në mënyrë që shpenzimet e punës të ndahen në mënyrë përpjestimore ndërmjet operatorëve përfitues sipas hapësirës së bashkëvendosjes së zënë.
9. Bashkëvendosja virtuale do të realizohet në të gjitha rastet në ambientet e ofruerit të aksesit pa instaluar ndarje apo struktura të tjera ndarëse, në rast se nuk bihet dakort ndryshe për këtë mes ofruerit të aksesit dhe operatorit përfitues.
10. Në të gjitha rastet, përjashtuar ato të përmendura në pikat 4.b dhe 5.b të këtij neni, operatori do të sigurojë një hapësirë bashkëvendosjeje brenda një periudhe kohore jo më të shkurtër se 15 ditë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes për sigurimin e aksesit.
11. Operatori përfitues mund ta përdorë hapësirën e bashkëvendosjes së përfutur, për të marrë shërbime aksesit të tipeve të ndryshme. Hapësira e alokuar e bashkëvendosjes mund të përdoret për interkoneksionin e rrjeteve të operatorëve përfitues.
12. Nëse operatorë përfitues të ndryshëm përdorin bashkëvendosjen në të njëjtat mjedise të një operatori ofrues, operatori ofrues nuk do të ndalojë operatorët përfitues të vendosin një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet rrjeteve të tyre elektronike të

komunikacioneve ose nga përdorimi i përbashkët i pajisjeve.

Neni 9

Përlllogaritje e detyrimeve financiare të interkoneksionit

1. Përlllogaritja e e detyrimeve financiare te interkoneksionit do të mbështetet tek parimi që, përlllogaritja dhe pagesa ndodhin ndërmjet operatorëve të cilët janë të interkonektuar drejtpërsëdrejti. Nëse një operator tranzitues është drejtpërsëdrejti i lidhur me një operator origjinues dhe operator terminues, operatori origjinues kryen pagesën për tranzitin dhe terminimin tek operatori tranzituse dhe operatori tranzitues kryen pagesën për terminimin te operatori terminues (përlllogaritje kaskadë).
2. Të gjitha matjet, rakordimi, faturimi dhe pagesat dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të mbështetet në marrëveshjen e interkoneksionit ndërmjet operatorëve të interkonektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.
3. Ne lidhjet indirekte te interkoneksionit:
 1. Një operator tranzitues nuk mund të refuzojë të paguajë operatorin terminues për shkak se ai nuk ka marrë pagesën nga operatori origjinues.
 2. Një operator terminues nuk duhet të bllokojë trafikun hyrës nga nje operator tranzitues për shkak të një mosmarrëveshjeje me një operator origjinues me të cilin nuk është i lidhur drejtpërsëdrejti, me përjashtim të rastit kur operatori origjinues ka borxhe të pashlyera ndaj operatorit terminues në bazë të një marrëveshjeje të mëparshme interkoneksioni. Ne keto raste operatori terminues ka te drejte te bllokoje vetem trafikun hyres te origjinuar nga serite numerike te operatorit origjinues.
4. Operatorët mund të vendosin një sistem për përlllogaritjen e detyrimeve financiare të interkoneksionit të ndryshëm nga ai i përshkruar në pikat 1 deri në 3 të këtij neni, nëse të gjithë operatorët e përfshirë bien dakort.
5. Marrëveshjet e interkoneksionit duhet të parashikojnë një procedurë për rastet e mosmarrëveshjeve për faturimin ose mospagimin, që siguron se shërbimi i ofruar përdoruesve fundorë nuk ndërpritet pa lajmërim paraprak.
 - a) Operatori që nuk ka bërë shkelje do të lëshojë një njoftim për shkelje për operatorin që ka kryer një shkelje dhe do të vendosë një afat kohor prej të paktën 10 ditësh për pagesën e shumës së duhur ose për të mbuluar një garanci për të cilën është rënë dakort.
 - b) Nëse operatori që ka kryer shkelje, nuk paguan dhe/ose mbulon garancinë, operatori që nuk ka kryer shkelje ka te drejte te pezulloje ofrimin e sherbimeve te interkoneksionit dhe që brenda jo më pak se 5 ditëve kalendarike të zgjidhë marrëveshjen e akses/interkoneksionit duke bërë njoftimin me shkrim përpara datës së bërjes efektive të ndërprejes përfundimtare të shërbimeve.Operatori që nuk ka kryer shkelje do të dërgojë një kopje të këtij njoftimi pranë AKEP-it.
 - c) Kur operatori që ka kryer shkeljen merr njoftimin e referuar tek pika 5.b) e këtij neni, operatori që ka kryer shkeljen duhet të njoftojë brenda 5 diteve të

gjithë klientët e tij (me shumicë apo me pakicë) të prekur nga ndërprerja/pezullimi i shërbimit, për pezullimin e shërbimit apo ndërprejen e përhershme të tij dhe zgjidhjet e mundshme, të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas këtyre kushteve të kontratave të lidhura me ta.

- d) Operatorët kanë të drejtë të kërkojnë që marrëveshjet e tyre të interkoneksionit të parashikojnë garanci financiare për pagesat. Garanci të tilla duhet të bazohen në parashikime të arsyeshme të volumeve të pritshme të trafikut dhe faturat korresponduese si dhe kalendari kohor i faturimit, rakordimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve. Shuma duhet të rishikohet rregullisht dhe duhet të garantojë që pagesat (e trafikut dhe pagesat e tjera të lidhuara me shërbimet e përfituara të aksesit/interkoneksionit) gjatë gjithë periudhës kohore të një mosmarrëveshjeje të mundshme, të garantohen deri sa mosmarrëveshja të zgjidhet ose interkoneksioni i drejtpërdrejtë të pezullohet apo shkëputet. Një operator ka të drejtë të refuzojë dhënien e aksesit/interkoneksionit nëse pala tjetër nuk ka dëshirë të përfshijë garancitë në kontratë.

KREU III

OFERTAT REFERENCE

Neni 10

Detyrimi për publikimin e ofertës së referencës

1. AKEP-i detyron një operator ofrues që të publikojë një ose më shumë oferta reference sipas dispozitave të neneve 39, 47 ose 52 të ligjit.
2. Ofertat e referencës për interkoneksionin e rrjeteve publike të telefonisë duhet të paktën të përmbajnë informacionin e parashikuar nga nenet 11, 12, , 13 dhe 14 të kësaj rregulloreje.
3. Ofertat e referencës për akses në qarkun lokal ose nën qarqet lokale duhet të përmbajnë të paktën informacionin e parashikuar nga neni 52, pika 7 e ligjit dhe nenet 11 dhe 15 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Kërkesat për përmbajtjen minimale të të gjithë ofertave të referencës

Të gjitha ofertat e referencës duhet të specifikojnë së paku si më poshtë:

- a) Përshkrim të shërbimeve dhe fasiliteve shoqëruese për t'u ofruar, përfshirë karakteristikat teknike të tyre;
- b) Informacionin për aksesin në elementët specifikë të rrjetit dhe/ose fasiliteve;
- c) Informacionin për vendet fizike të aksesit, hyrjen në ambientet dhe infrastrukturën e komunikimeve elektronike;
- d) Kushtet teknike që kanë të bëjnë me aksesin, përfshirë karakteristikat teknike të aksesit;
- e) Fasilitetet e tjera të shoqëruara (shërbimet) të nevojshme për të garantuar mundësimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike për përdoruesit

- përmes aksesit të siguruar për operatorin përfitues;
- f) Kushtet për përdorimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike të ofruesit të aksesit (kabllot, kanalet, kullat, tubacionet, etj), të lidhura me sigurimin e aksesit;
 - g) Shërbimet e shoqëruara me sigurimin e bashkëvendosjes, sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje;
 - h) Informacionin për aksesin në sistemet mbështetese të veprimtarisë;
 - i) Kushtet sipas të cilave pika e aksesit, në rast të dëshirës së operatorit përfitues, mund të lidhet në rrjetin e operuar nga operatori përfitues përmes radiofrekuencave;
 - j) Kufizimet (nëse ka të tilla) për pajisjet që disa operatorë mund të vendosin në të njëjtin vend.
 - k) Parametrat e cilësisë së aksesit;
 - l) Masat që sigurojnë integritetin dhe sigurinë e rrjetit të ofruesit të aksesit;
 - m) Standardet e nevojshme për dhenien e aksesit;
 - n) Kushtet dhe procedurat për sigurimin e secilit shërbim, përfshirë:
 - i. Formularin standard të kërkesës për sigurimin e secilit shërbim;
 - ii. Periudhën e kohës për përgjigjen ndaj kërkesës;
 - iii. Periudhën e kohës për lëvrimin e shërbimeve dhe/ose pajisjeve;
 - iv. Periudhën maksimale të kohës për eliminimin e dështimeve;
 - v. Marrëveshjet për nivelin e shërbimit (Service Level Agreement);
 - vi. Kushtet standarde të marrëveshjes së sigurimit të aksesit, procedurat për zhdëmtimin në rastet kur përgjigja ndaj një kërkesë për të siguruar një shërbim të caktuar vonohet tej afateve të përcaktuara, dhe formularin standard të angazhimeve të konfidencialitetit;
 - o) Tarifat për secilin shërbim (përfshirë pagesën për lidhjen fillestare, pagesat që kryhen vetëm një herë, pagesat periodike dhe pagesat e tjera, në rastin kur tarifat diferencohen, ky fakt duhet të specifikohet) dhe/ose formulat (algoritmet) e përlllogaritjes së tyre;
 - p) Afatet kohore dhe kushtet e pagesave;
 - q) Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në bazë të parimit që palët duhet të mundohen të zgjidhin mosmarrëveshjet para se t'ia paraqesin çështjen AKEP-it ose gjykatës;
 - r) Dispozita të qarta për ekzekutimin dhe datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes, kohëzgjatjen, dhe procedurën për ripërtëritjen dhe ndryshimin e saj, duke përfshirë që negociimet për ripërtëritjen e marrëveshjes duhet të nisin jo më vonë se dy muaj para datës së përfundimit të marrëveshjes ekzistuese;
 - s) Dispozitat në rast përfundimi të njëanshëm;
 - t) Të drejtat e pronësisë intelektuale

- u) Akses tek shërbimet suplementare, ndihmëse dhe të përparuara;
- v) Mosdhënia e informacionit konfidencial;
- w) Masat për plotësimin e kërkesave themelore për sigurinë dhe integritetin e rrjetit;
- x) Forca madhore.

Neni 12

Ofertat e referencës për interkoneksionin e rrjeteve publike të telefonisë

Në lidhje me interkoneksionin e rrjeteve publike të telefonisë, oferta e referencës së operatorit ofrues duhet në veçanti të përshkruaje:

- a) Shërbimet e ofruara nga çdo palë, përfshirë:
 - i. qarqet e interkoneksionit: numrin, llojin, kapacitetet, pala ofruese (pronësia) e qarqeve të interkoneksionit;
 - ii. llojet e trafikut që do të shkëmbehet midis paleve dhe mënyren e rrugëzimit të trafikut sipas llojeve dhe destinacioneve;
 - iii. për çdo shërbim të ofruar njera-tjetres dhe trafik të shkëmbyer midis palëve duhet të ketë përshkrime dhe përcaktime të qarta të realizimit të shërbimeve dhe pagesave të detyrimeve reciproke;
 - iv. përcaktime të qarta në marrëveshjen e interkoneksionit për shkëmbimin e informacionit të identifikimit të përdoruesit thirrës (CLI). Palët të marrin përsipër që në asnjë rast nuk do të tjetersojnë përmbajtjen e fushës përkatëse të CLI në formatin përkatës të paketës së sinjalizimit.
- b) Pikat e interkoneksionit dhe pajisjet e interkoneksionit duke përfshirë:
 - i. vendndodhjen gjeografike të pikave të interkoneksionit midis rrjeteve, me adresat e sakta të tyre;
 - ii. përshkrim të pajisjeve që do të përdoren për interkonektimin e rrjeteve (p.sh. terminale të fibrave optike);
 - iii. specifikime të kërkesave për kapacitete dhe/ose volum të trafikut;
 - iv. informacion të plotë për pajisjet dhe fasilitetet që ofron secila palë (duke përfshirë skemën e Pikave të Interkoneksionit dhe fasiliteve);
- c) Specifikime teknike:
 - i. llojin e standardeve/rrjeteve të sinjalizimit (p.sh Sistemi i sinjalizimit #7);
 - ii. pikat e transferimit të sinjalit (Signal Transfer Points);
 - iii. specifikimet e ndërfaqeve teknike;
 - iv. skeme të arkitektures së interkoneksionit;
 - v. Calling Line Identification (CLI);
 - vi. shërbime dixhitale të avancuara, si transferim i thirrjes, ID e palës thirrëse, etj.;
- d) Ndryshimet e rrjetit, në veçanti duke përfshirë detyrimin që secila palë të njoftojë

palën tjetër në rast të ndryshimeve në rrjet dhe në parashikimet për kapacitetet:

- i. parashikim të trafikut për çdo pikë interkoneksioni;
 - ii. ndryshimet e pritshme në numeracion;
 - iii. rrugëzime të pashfrytëzuara me efektivitet apo të tepërta, si dhe nevojat për rrugëzime shtesë;
 - iv. njoftime për planifikime periodike të ndryshimeve në rrjet;
 - v. procedura për porositjen e fasiliteve;
- e) Bashkëvendosjen dhe përdorimin e përbashkët të infrastrukturës sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje;
- f) Matjen e trafikut dhe rrugëzimin, në veçanti:
- i. përgjegjësitë e palëve për procedurat e matjes dhe raportimit të trafikut;
 - ii. rregullat për rrugëzimin e llojeve të ndryshme të trafikut;
- g) Procedurat e faturimit dhe afatet e pagesave, në veçanti:
- i. procedurat e faturimit, rakordimit të trafikut dhe pagesave, mënyren e kryerjes së pagesave dhe të sigurojë që të paguhen të gjitha detyrimet fiskale sipas legjislacionit në fuqi. Palët duhet të faturojnë njera-tjetrën për të gjitha shërbimet e ofruara.
 - ii. elementët dhe formati i faturave për shërbimet e ofruara;
 - iii. komisione të aplikueshme për shërbimet e faturimit (në se aplikohen);
 - iv. kohën e ruajtjes së të dhënave për faturat e lëshuara;
 - v. detyrimet e veçanta për operatorët transit sipas pikës a) të nenit 12, të kësaj rregulloreje;
 - vi. përshkrimin e sistemit të pagesës i cili duhet të jetë transparent për çdo palë;
 - vii. dëmshperblim (kamatë) për vonesa në pagesa sipas afateve të rëna dakord dhe shkëputje të shërbimit në rast të mospagesave sipas afateve të përcaktuara;
 - viii. procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me rakordimin dhe faturimin e trafikut;
 - ix. pikat e kontaktit për rastet e sqarimeve rreth faturave;
- h) Cilësia e shërbimit, raportimi i defekteve dhe në veçanti:
- i. koha mesatare për sigurimin e qarqeve të interkoneksionit;
 - ii. përqindje të ndërprerjeve të interkoneksionit;
 - iii. tregues të krahasimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara për vetveten (dhe/ose operatorëve të tjerë) dhe operatorin e interkonektuar (palën tjetër);
 - iv. të drejta për të kryer teste të arsyeshme dhe të programimit për ndërprerje të shërbimit, procedurat për minimizimin e shëputjeve;
 - v. procedura për raportimin e defekteve, periudhën e njoftimit dhe përgjigjes;

- vi. detyrimin për të kontrolluar rrjetin e vet përpara raportimit të defekteve të operatorit tjetër;
- vii. përgjegjësitë e të dy palëve për të ndërmarrë masat e duhur për të parandaluar interferencat me rrjetet e tjerë, ose ndërprerje të shërbimeve të interkoneksionit; etj.
- i) Përcaktimi dhe kufizimi i detyrimeve dhe dëmshpërblimeve, në veçanti rastet, masën dhe mënyrën e aplikimit të dëmshpërblimeve në raste të mosrealizimit të detyrimeve të marra përsipër në marrëveshje;
- j) Përcaktimi i tarifave të interkoneksionit për çdo shërbim të ofruar njera-tjetrës dhe procedurën për ndryshimin e tyre përgjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes.

Neni 13

Shërbimet për interkoneksionin e rrjeteve publike të telefonisë

1. Operatori ofrues për interkoneksionin e rrjeteve publike të telefonisë duhet të përfshijë shërbimet e mëposhtme, në masën që operatori ofrues është i detyruar për të ofruar këto shërbime sipas ligjit dhe vendimeve të AKEP:
 - a) Shërbimet e terminimit të thirrjeve;
 - b) Shërbimet e origjinimit të thirrjeve, në veçanti për shërbimet për përzgjedhjen e bartësit dhe parazgjedhjen e bartësit (carrier pre-selection);
 - c) Shërbimet e tranzitimit të thirrjeve;
 - d) Shërbimet e lidhjes së rrjetit, përfshirë shërbimet e sinjalizimit, shërbimet e sinkronizimit dhe shërbimet e testimit;
 - e) Thirrjet drejt shërbimeve të urgjencës (drejt numrave të shkurtër të shërbimeve të urgjencës dhe drejt numrit të njesuar të shërbimeve të urgjencës);
 - f) Shërbimet e implementimit të numeracionit, përfshirë;
 - i. Shërbimet e implementimit të serive të numrave jogjeografikë;
 - ii. Informacionin për shërbimet e implementimit të serive të numrave gjeografikë në rastin e një ofruesi aksesit që ofron rrjet publik fiks të komunikimeve;
2. Oferta e referencës e operatorit ofrues duhet të përfshijë dispozita të kapaciteteve të pikave të interkoneksionit, duke përfshirë si më poshtë:
 - a) Lidhje të reja të interkoneksionit në linjat ekzistuese të interkoneksionit duke përdorur një pikë interkoneksioni ekzistuese (shtimi i kapacitetit);
 - b) Linjat e reja të interkoneksionit që përdorin një pikë ekzistuese të interkoneksionit;
 - c) Pikat e reja të interkoneksionit që përdorin interkoneksionin e bashkëvendosur (në anën e operatorit ofrues);
 - d) Pikat e reja të interkoneksionit që përdorin interkoneksionin në anën e operatorit përfitues (customer sited);

- e) Pikat e reja të interkoneksionit që përdorin interkoneksionin në mes, të ndërmjetëm (in-span) mes operatorit ofrues dhe operatorit përfitues.
3. Nëse një operator ofrues që ofron rrjet publik të lëvizshëm ka detyrimin t'u ofrojë akses operatorëve të rrjeteve virtuale të lëvizshme (MVNO) oferta e referencës duhet të përshkruajë shërbime të tilla të rrjeteve virtuale të lëvizshme. Shërbime të tilla do të pëfshihen në ofertën referencë të interkoneksionit, ose në një ofertë të veçantë reference, sipas përcaktimeve të AKEP.

Neni 14

Bashkëvendosja

Në lidhje me bashkëvendosjen, të gjitha ofertat e referencës duhet të përshkruajnë të paktën si më poshtë:

- a) Kushtet për sigurimin e bashkëvendosjes fizike, në distancë dhe virtuale;
- b) Kushtet për sigurinë e bashkëvendosjes, të përcaktuara nga operatori ofrues dhe mjetet për garantimin e kërkesave të shprehura;
- c) Kushtet sipas të cilave operatori përfitues do të ketë mundësinë për të inspektuar vendet në të cilat do të vendosen pajisjet;
- d) Parametrat teknikë, karakteristikat dhe kufizimet (nëse ka) për pajisjet që mund të instalohen në vendet e bashkëvendosjes;
- e) Kushtet e hyrjes së punonjësve të operatorit përfitues në një vend të bashkëvendosjes;
- f) Rregullat për alokimin e hapësirës së bashkëvendosjes mes operatorëve përfitues, në rast se kjo hapësirë është e kufizuar. Këto rregulla duhet të parashikojnë mundësinë e përdorimit të një vendi të bashkëvendosjes për disa operatorë përfitues;
- g) Kushtet, sipas të cilave operatori përfitues do të ketë mundësinë për të inspektuar vendet e bashkëvendosjes në rastet kur i refuzohet kërkesa për bashkëvendosje;

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

AKEP do të zgjidhë të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet operatorëve për aksesin dhe interkoneksionin në përputhje me dispozitat e nenit 120 të ligjit dhe rregulloren Nr.18, datë 11.06.2010 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

Neni 16

Dispozita tranzitore

Operatorët mund të vazhdojnë të përdorin ofertat e referencës të publikuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, deri 30 ditë pas datës së hyrjes në fuqi të saj (Rregullores).

Neni 17

Shfuqizimi

Rregullorja “Për Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me vendimin nr. 416, datë 07.12.2007 të Këshillit Drejtues të ERT-së, shfuqizohet.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Rregullorja e miratuar nga Këshilli Drejtues do të hyjë në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj në faqen e internetit të AKEP .